V E N D I M
Nr.378, datë 12.8.1999

PËR KALIMIN E SË DREJTËS TË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT PËR DISA OBJEKTE PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të ligjit nr.8482, datë 10.5.1999 "Për një shtesë në ligjin nr.7926, datë 10.5.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me akte të tjera ligjore, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Organeve të qeverisjes vendore u kalohet e drejta e përfaqësuesit të pronarit për pronën shtetërore, për objektet sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Destinacioni i këtyre objekteve do të ndryshojë në drejtime me interes publik, si dhe për strehim.
3. Destinacioni i objekteve të shërbimit shëndetësor dhe ai i parqeve të udhëtarëve nuk do të ndryshojë.
4. Në rastet kur organet e qeverisjes vendore marrin vendim për kalimin e pronësisë së këtyre objekteve, subjekteve private, të procedohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko